



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 267, datë 10.12.2024

PËR

**“CAKTIMIN E ANËTARIT PËRGJEGJËS TË KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË PËR KOMUNIKIMIN ME MEDIAN”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar (në mungesë)
3. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
4. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
5. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
6. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
7. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
8. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
9. Zotit Erind GËRMENJI	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zoti Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 10.12.2024, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar dhe në nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Caktimin e anëtarit përgjegjës të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për komunikimin me median”

BAZA LIGJORE:



1. Nenet 149, pika 1, 149/a, pika 1, germa "e", të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë;
2. Nenet 159, pika 2, germa "dh", 185 dhe 189, pika 1, germa "c", të ligjit nr. 115/2016, "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*" i ndryshuar;
3. Pikën 4 të Rregullores "*Për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me median*";
4. Neni 51, germa "g", të Rregullores "*Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë*".

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP) informon publikun dhe median lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së tij kushtetuese dhe ligjore. Ky informim realizohet për raportet vjetore të punës, deklaratat publike, publikimit të akteve në faqen zyrtare të internetit, intervistat, trajtimin të kërkesave për informacion, sigurimit të aksesit të medias në mbledhjet plenare, etj.
2. Për të vendosur një komunikimin të qëndrueshëm me median, si dhe për të rregulluar aspekte të ndryshme të këtij komunikimi, KLP duhet të caktojë një nga anëtarët e tij për të ndjekur këtë proces në përputhje me rregullat përkatëse.
3. Në Rregulloren "*Për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me median*", KLP ka miratuar parimet, rregullat e hollësishme dhe procedurat e veçanta për, komunikimin e ligjshëm, transparent, të përgjegjshëm dhe profesional të Këshillit me median e shkruar dhe elektronike, si dhe me çdo përfaqësues të saj.
4. Komunikimi përfshin të gjitha mënyrat e vendosjes së kontakteve institucionale ndërmjet Këshillit dhe medias, si dhe shkëmbimin e informacionit në formë të shkruar, audio, video apo të dhëna.
5. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në sferën e komunikimit me median dhe publikun, me qëllim garantimin e pasqyrimin të qëndrimit institucional të KLP-së në funksion të transparencës me median dhe publikun.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se:

6. Ekziston nevoja për caktimin e një anëtari nga radhët e Këshillit, detyrat e të cilit janë organizimi i punës brenda institucionit, me qëllim vlerësimin, përgatitjen dhe redaktimin e një informacioni përmbledhës e të qartë, i cili garanton qëndrimin transparent, profesional dhe institucional të Këshillit në raport me median dhe publikun.
7. Anëtari i caktuar të përfaqësojë Këshillin me median, asistohet nga specialisti për marrëdhënien me publikun dhe Koordinatori i të Drejtës për Informim.

8. Për sa më sipër, në seancë plenare të datës 10.12.2024, u propozua që, anëtari nga radhët e prokurorëve zoti Zeqir Hoda, të caktohet si anëtari përgjegjës i Këshillit për komunikimin me median.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149, pika 1, 149/a, pika 1, germa "e", të Kushtetutës, nenet 159, pika 2, germa "dh", 185 dhe 189, pika 1, germa "c" të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, pikën 4 të Rregullores për "Komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me median", nenin 51, germa "g", të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Caktimin e zotit Zeqir Hoda si anëtari përgjegjës i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për komunikimin me median.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 10.12.2024.



KRYETAR

Mirela Bogdani

ANËTAR

Ledina Riza

ANËTAR

Olger Eminaj

ANËTAR

Moisi Duda

ANËTAR

Erind Gërmenji

ANËTAR

Zeqir Hoda

ANËTAR

Vatë Staka

ANËTAR

Erind Merkuri

ANËTAR

Erion Fejzulla